

shqiptarët në përgjithësi, kurse te shqiptarët e Jugosllavisë në veçanti. Te shqiptarët tanë ky zakon është i pastudjuar dhe në hartën gjeografike paraqet një njollë të bardhë. Padyshim që është meritë e N. Pavkoviçit që ka shënuar një numër të konsiderueshëm të dhënash për të drejtën e parablerjes të shqiptarëve të Kosovës. Mjafton që kjo gjë ka për të shërbyer si cytje për albanologët që merren ose do të merren me etnologjinë shqiptare, që këtij problemi të etnologjisë juridike t'i kushtojnë kujdesin e merituar, sepse hulumtimi i kësaj dukurie etnologjike te shqiptarët e Jugosllavisë është temë interesante dhe e dobishme.

Studimi i këtij problemi te shqiptarët padyshim do t'i ofrojë shkencës etnologjike të dhëna dhe njohuri të

çmueshme. Do të shohim, për shembull, nëse objekt të drejte të parablerjes është vetëm toka dhe përgjithësisht sendet e pa luejtshme ose edhe bagëtia (sikurse ka shënuar autori)? Mbase mu ky zakon përfaqëson njërin nga burimet e ruajtjes së zakonit prapanik të gjakmarrjes, e cila në konën e sotme është një anakronizëm? Përkërisht ky institucion është shndërruar prej një instrumenti për mbrojtjen e interesave të përbashkëta ekonomike në një fenomen krejt të kundërt, në instrument për mbrojtjen dhe ruajtjen e pronësisë private? Ndoshta e drejta e parablerjes paraqet një pengesë në migrimin dhe lëvizjen e lirë të popullsisë, respektivisht për shpërnguljen e saj prej fshatit në qytet dhe kështu me radhë.

KADRI HALIMI

Demush Shala: KËNGË POPULLORE LEGJENDARE, botoi Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1972, 8^o f. 303.

Në krahasim me botimet e rralla të letërsisë sonë gojore gjatë 20 viteve të pasçlirimit, viti 1972 paraqet një kthesë të madhe jo vetëm sa i përket kuantitetit, por në radhë të parë cilësisë së materialeve të botura në Kosovë. Botohen: *Prozë popullore nga Drenica I, II* (A. Çetta), *Këngë popullore legjendare* (D. Shala), *Këngë popullore lirike* (D. Shala), *Frazeologjizma të gjuhës shqipe* (M. Gjevorri), *Prozë popullore e Drenicës* (H. Kajtazi), dhe *Nga lirika popullore e Drenicës* (H. Kajtazi).

Demush Shala, mbledhës dhe studjues i zellshëm i letërsisë sonë gojore, bëri një punë të mirë kur i hyri hartimit të blejve: *Këngë popullore legjendare*, *Këngë popullore lirike* *Këngë popullore historike* (1973) si dhe tekstit për shkolla të mesme *Letërsi popullore shqiptare*, i vetmi i këtij lloji ndër ne. Derisa në tekstin shkollor *Letërsi popullore shqiptare* bën interpretime teorike të letërsisë gojore dhe llojeve të saj, duke gërrshëtuar mendimet e veta me rezultatet e njohura në lëmi ne folkloristikës përgjithësisht si dhe duke shtruar e shkoqitur dhe ndonjë dukuri me

interes, tre blejt e tjerë me këngë popullore janë përmbledhje materiale të folklorit letrar të nxjerra qoftë nga botimet e gjertanishme të veçanta, qoftë dhe nga revistat e ndryshme. Poashtu në këta tre blej janë botuar materiale nga dorëshkrimet e disa autorëve apo të mbledhura nga vetë D. Shala. Pos materialeve të zgjedhura me shije e me një vlerë të pamohueshme letrare-artistike, këtyre tre vëllimeve u prijnë dhe parathëniet, që pamëdyshje do t'u ndihmojnë nxënësve e studentëve, të cilët tani nga letërsia gojore (sidomos studentët e gjuhës dhe të letërsisë shqipe) kanë një fond më të madh orësh.

Në *Këngë popullore legjendare* janë përfshirë balada, romansa, këngë kreshnikësh si dhe këngë për Gjergj Elez Alinë. Veprës i prin një parathënie rreth 60 faqesh, në të cilën autori bën fjalë për secilin lloj të këtyre këngëve si dhe për vlerën e tyre letrare. Herë-herë, bëhen përpjekje që çështja të shtrohet, si te motivi i muosjes, në përmasa më të gjera. Parathënien kryesisht e karakterizon metoda pozitiviste deskriptive e studimit dhe interpretimit të letërsisë.

Autori në fillim na njofton, pos të tjerash, se është përpjekur të zgjedhë këngët dhe motërzimet më të bukura brenda kushteve dhe mundësi-ve. Duke botuar variantet e ndryshme ai ka pasur për qëllim të vejë në pah edhe shtrirjen gjeografike të këtyre këngëve në popull. Megjithatë, qëllimi i tij kryesor ka qenë t'ia afrojë lexuesit një lëndë sintetike të materialeve të botuara më parë për të dëshmuar vlerat e larta artistike të letërsisë sonë gojore.

Demush Shala blenin e ka ndarë në dhjetë pjesë, kryesisht duke u mbështetur në motivet dhe tematikën e këngëve, për të cilat flet në parathënie veç e veç. Një ndarje e këtillë, që është përdorur dhe në botimet e mëparshme, ndihmon t'i vërejmë më lehtë karakteristikat e këtyre llojeve të epikës sonë gojore, disa nga të cilat tipare i ka shkoqitur dhe vetë autori. Blenin e përcjell dhe aparatura e nevojshme shkencore: fjalori, burimet e lëndës, shënime për regjistrimin e këngëve dhe bibliografia.

Duke bërë fjalë për kapitullin I — „Legjendat e metamorfizimit dhe ato me karakter mitik” (E Motra e Agës Hasan Agë bahet qyqe, Dekë e Hasapit, Motra me nandë vllazni, Djali gjarpër, Parasten Kontesha Kontë) D. Shala thekson se janë — ndër krijimet poetike popullore më të vjetra që njeh letërsia jonë dhe se këto krijime lindën krahas me përrallën dhe mitin, por që me kohë fituan dhe ndonjë element të ri, që i ka përtrirë dhe i ka mbajtur ato të gjalla. Siç mund të vërejmë dhe nga vetë titulli i kësaj kapitule, Demush Shala ka futur baladat, me motiv të njohur të metamorfizimit dhe, sipas tij, romansën „shumë të bukur”, *Parasten Kontesha Kontë*. Në qoftë se balada dhe romansa, si lloje të krijimit letrar gojor, ndryshojnë nga njëra tjetra, atëherë ato nuk do të duhej të gjindehin në një grup. Disa nga baladat e motivit të metamorfizimit na japin të dhëna për elemente raportesh sociale të kohës, e kanë të theksuar notën elegjiake, por i karakterizon elementi dramatik dhe shprehja e fuqishme artistike.

Motivi i murosjes është shumë i vjetër. Sipas autorit ai është i lidhur ngushtë me stadin më primitiv të

shoqërisë njerëzore. Në kaptinën (II) — Legjenda e murosjes së gruas, ku janë përfshirë këngët: I ra mjegulla Bunës, Tre t'hasjanë kanë ra në Gjakovë, Punë marë mre ustallarë, Urë, moj e mjera urë etj., autori shtron në vija të shkurtëra motivin e murosjes, duke theksuar disa nga karakteristikat e krijimeve tona. Disa nga këto balada janë ndër më të dhimbshmet të letërsisë tonë gojore.

„Legjendat e vëllaut të vdekur” (Konstadini dhe Garentina, Kënga e Dhoqinës, Aliu dhe Fata, Halil Garria dhe Motra me nandë vëllazën) i karakterizojnë shprehjet e dendura lirike, të gëshëtuara me ndonjë notë të thellë elegjiake, kryesisht familjare si dhe një stil i thjeshtë dhe konciz.

Në „Legjenda të rinjohjes së burrit me gruan” janë përfshirë pesë variante të këtij motivi të përhapur mjaft në letërsinë tonë gojore, të cilat dëshmojnë për një jetë të vështirë të një periudhe të caktuar. Krijime, të cilat autori i quan romansa, „u krijuan në kohën e pushtimit të viseve ballkanike nga ana e osmanëve”.

„Olipia dhe vllastari”, Gjon Preti-ka”, „Lute Fukareja” etj. janë krijimet që e përbëjnë kaptinën: Legjenda e rinjohjes së vëllait me motrën, në të cilat pasqyrohen aspekte të marrëdhënieve shoqërore. Sipas tematikës më të ngushtë autori këto këngë i ndan në dy grupe, a) këngë kur vëllai largohet për një kohë më të gjatë, si jeniçer, nizam apo hajdut dhe, b) këngë që shprehin gjendjen e vështirë ekonomike me pasoja të rënda për popullin.

Edhe „Legjendat e rinjohjes së vëllait me vëllanë dhe të vëllavrasjes” kanë të thuash ato karakteristika të këngëve të rinjohjes së vëllait me motrën, por ndofta me një fuqi narrative më të theksuar.

Këngët që botohen në „Dashuria tragjike e dy të rinjve” (Hasan Aga dhe çika Patureshë etj.) shprehin tragjikën e thellë të të rinjve, shkaktuar nga normat prapanike e konservatore të familjes patriarkale. Në „Legjenda të ndryshme” (10 sosh) janë përfshirë këngë që trajtojnë motive të reja nga jeta, shprehin disa aspekte që nuk i ndeshim në këngët e përmendura më lart.

Kapitull i veçantë dhe me interes i këtij bleni është ai i „Këngëve kreshnike”, ku autori ka përfshirë materiale ndër më të mirat që janë botuar gjer tani — gjithsejt 21 këngë, për të cilat bën fjalë gjerësisht në parathënie. Demush Shala konsideron se këto këngë janë shumë të vjetra dhe ndofta i takojnë periudhës iliro-thrake. Pa dashur të hyjmë në çështjen e gjenezës së këtyre këngëve, respektivisht hipotezës që shtron ai, po theksojmë se këto këngë, me karakteristikat e veçanta, paraqesin një kualitet e vlerë të pamohueshme artistike të letërsisë sonë gojore përgjithësisht, qoftë për fjalët e shprehjet e pasura, për tropet dhe figurat e shumta, qoftë për fuqinë narrative në përshkrimin e epizodeve të ndryshme. Në fund të vëllimit autori ka futur dhe „Këngët mbi Gjergj Elez Alinë” (një këngë dhe një variante). Padyshim që është çështje në vete se a kanë këto dy këngë karakteristikat specifike që të meritojnë të botohen kështu të veçuara. Sidoqoftë, kënga e Gjergj Elez Alisë është një ndër krijimet më të bukura të letërsisë sonë gojore.

Sikurse çdo botimi të tillë, edhe këtij bleni të Demush Shalës mund t'i bëhen disa vërejtje, të cilat ai duhet t'i ketë parasysh me rastin e ribotimit. Fitohet përshtypja se autori, duke synuar të përfshijë shtrirjen gjeografike sa më të gjerë të këngëve, nuk ka arritur kurdoherë t'i mbetet besnik parimit që ka përmendur në fillim — të botojë vlerat më të mira nga këto lloje këngësh. Çështje më vete është terminologjia. Shpesh bëhet identifikimi: Legjendë-baladë, legjendë-romansë, legjendë-këngë kreshnike etj. Termi folkloristika ka një

kuptim të gjerë dhe nuk është përdorur përherë me vend. Kur flitet për krijimet e letërsisë gojore, ky term duhet të përdoret në raste specifike. Për letërsinë e shkruar autori përdor termin *letërsi e kultivuar* apo *artistike*, edhe pse shpeshherë flet për vlerat e mëdha artistike të letërsisë gojore dhe për kultivimin e saj gojë me gojë e brez pas brezi, me shekuj. Gjithashtu ai përdor termin *letërsi popullore*, herë gojore, traditë popullore e herë-herë folklor e folkloristike (këtë të fundit e përdor në dy kuptime: herë si lëndë e herë si mënyrë, metodë interpretimi a studimi të kësaj lëndë).

Me rastin e ribotimit duhet të futen sa më pak motërzime dhe të kihet parasysh niveli i tyre artistik. Duhet poashtu të evitohen disa gabime teknike (në fjalor) e të shënohen dhe disa fjalë të huaja (si *uvladin*, *puste*, *novinar* etj.). Të shkruhet drejt emri i mbledhësit dhe studjuesit të zellshëm të letërsisë sonë gojore Qemal Haxhihasanit (në të gjitha rastet) e jo Qamil. Të përmirësohet data e botimit të *Rapsodive të De Radës* (1866) e jo sikur ka dalur (1868), të shënohen drejt disa tituj të veprave në bibliografi etj.

Sidoqoftë, përkundër këtyre lëshimeve që janë ndofta dhe rezultat i natyrës komplekse të hartimit të vëllimeve të këtilla, *Këngët popullore legjendare*, përpiluar nga Demush Shala, të prira nga një parathënie e gjatë shkruar nga autori, është ble i çmueshëm, që u mirëprit nga shumë lexues, nxënës e studentë. Ai plotësoi një zbrast të madhe që ndihej për këngët popullore epike në Kosovë, jo më pak se 20 vite.

ANTON BERISHA

Demush Shala: KËNGË POPULLORE LIRIKE, botoi Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1972, 8^o f. 291.

Bleni KËNGË POPULLORE LIRIKE, hartuar nga Demush Shala, përfshin thuajse të gjitha format e lirikës sonë gojore. Materiali është i ndarë në nëntë kapituj. Librit i prin një parathënie, ku në mënyrë kronologji-

ke bëhet fjalë për disa nga veçoritë e këtyre llojeve të krijimtarisë sonë poetike gojore. Vëllimi është i pasur si për kah tematika, ashtu dhe për kah vlerat letrare-artistike. Për hartimin e tij Demush Shala ka shfrytë-